Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

| | | |
|---|---|---|
| APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE | | |
| 1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME | | |
| 1.1. Të dhënat për Operatorin | | |
| 1.1.1. | Emri i subjektit | **"GËRLICA - COMPANY" SH.P.K.** |
| | Vendi | **Gadime e Ulet dhe Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan** |
| | Adresa | **Babush, K. Ferizaj** |
| | Nr. i tel./fax | **+383 (49) 755 505** |
| | E-mail | **info@gerlica.com** |
| 1.1.2. | Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit | **Certifikata e regjistrimit te Biznesit, Nr. Unik Identifikues: 810305616, Dt. 12/06/2007** |
| 1.1.3. | Personi Përgjegjës i kompanisë | **Genc Thaçi, Person i Autorizuar pergjegjes** |
| | Nr. i tel./fax | **+383 (49) 755 505** |
| | E-mail | **info@gerlica.com** |
| **1.2. Të dhënat për impiantin** | | |
| 1.2.1. | Emri i impiantit | **Eksploatimi, Bluarja dhe Seperimi i Gurit Gëlqeror** |
| 1.2.2. | Adresa e lokacionit tëimpiantit | **Gadime e Ulet dhe Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan** |

SHOQERI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
SH.P.K.
GËRLICA COMPANY
FERIZAJ

SHTOJCA 3

Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore

| | |
|---|---|
| Emri i kompanisë | **"GËRLICA - COMPANY" SH.P.K.** |
| Lloji i veprimtarisë | **Gurore** |
| Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë | **Gadime e Ulet dhe Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan** |
| Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë | **Ahmet Vogliqi, Pronar** |
| Adresa | **Babush, K. Ferizaj** |
| Telefoni, fax, e-mail | **+383 (49) 755 505, info@gerlica.com** |
| Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis | **Genc Thaçi, Person i Autorizuar pergjegjes** |
| Adresa | **Babush, K. Ferizaj** |
| Telefoni, fax, e-mail | **+383 (49) 755 505, info@gerlica.com** |
| Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake | **6042-2/19, Datë. 10.03.2020** |
| Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit | **1. Certifikata e regjistrimit te Biznesit, Nr. Unik Identifikues: 810305616, Dt. 12/06/2007**<br>**2. Leja Mjedisore me nr. 6042-2/19, Datë. 10.03.2020,**<br>**3. Licenca 2097/KPMM/2020, Nr. Prot. 2621, 20.07.2020**<br>**4. Licenca 995/KPMM/2026, Nr. Prot. 1454, 30.01.2026** |
| Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore | **Po** |
| Pesë(5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD) | **Po** |

SHOQERI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA SH.P.K. GËRLICA COMPANY FERIZAJ

"GERLICA COMPANY SH.P.K"
Babush – Ferizaj

# PROJEKTI PËR LEJE MJEDISORE

# EKSPLOATIM, SHFRYTËZIM, THERMIM, DHE SEPERIM TË GURIT GELQERORË

Mars 2025

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
SH.P.K
GËRLICA COMPANY
FERIZAJ

| | | |
|---|---|---|
| | | gëlqeror. Prandaj ndikimet kryesore në mjedis janë në ajër,ujë,tokë dhe ndikimet nga zhurma.<br>Të gjitha ndikimet tjera janë të pa përfillura. Këto ndikime janë të paraqitura në pikat 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.5. të Aplikacionit për dhënien e Lejes Mjedisore |

| | | |
|---|---|---|
| **2. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË** | | |
| 1.1. **Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore** | | |
| 1.1.1. | Skema e procesit teknologjik | Duke u bazuar në veprimtarin zhvilluese të kompanisë dhe nevojave të zgjërimit të biznesit pëshkak të kërkesave të tregut kompania'GËRLICA-COMPANY" SH.P.K. " ka pru vendim për zhgjërimin e kapaciteteve prodhuese me një linjë të re.<br>1.1 Projekti teknologjik për Eksploatim(shfrytëzim), Bluarje , Thyerje dhe Seperim të gurit gëlqeror<br>Projekti do të punohet tërsisht sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe standardeve për objekte investive tekniko-teknologjike , I cili në bazë të detyrave projektuese përbëhet nga:<br><br>1.Fortina (Bunkeri) me kapacitet pranues $30m^3$<br>2. Tavolina dozuese |

| | | |
|---|---|---|
| | | 3. Grilla ndarëse<br>4.Thërmuesi me nofulla<br>5. Shiriti kryesor transportues<br>7.Parasita<br>8. Mulliri me çekiça (primar)<br>9.Thërmuesi rrotativ (sekondar)<br>10.Sita primare vibruese tre katëshe<br>11. Shiritat transportues për frakcionet e seperuara 0-4mm; 4-8mm; 8-16mm dhe 16- 32mm<br><br>1. Fortina (Bunkeri pranues)<br>Pothuajse te të gjitha linjat e gurëthyesve pozita e pare nga e cila fillon proqesi teknologjik I bluarjes dhe seperimit të gurit gëlqeror apo në përgjithësi të gurve të forte është bunkeri pranues I gurit të sjellur nfusha e shfrytëzimit. Në linjën II të kompanisë "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K. " bunkeri pranues ka një kapacitet afro 30 $m^3$ skematikisht duket sin ë fig 1. |



2. Tavolina dozuese me sistem vibrimi
Në pjesën e poshtme të fortinës është e vendosur tavolina dozuese e cila bënë ushqimin e thërmuesit primar me traj, kjo tavolinë punon me sistem vibrimi, vibrimet e të cilit electromotor janë të sinkronizuara me kapacitetin përpunues të thërmuesit primar në mënyrë që të mos vie deri te ndonjë moment që të ketë pengesa të llojit të ndryshëm. Fig 2.



3. Grilla ndarëse

Grilla ndarëse është mekanizëm I cili bën ndarjen e materialit shterpë I cili është pjesë e materialit të minuar në fushën e shfrytëzimit. Grila ndarëse është e përbërë nga një sistem shufrash të vendosura në tre rende njëra pas tjetrës në formën kaskadë. Këto shufra janë të përbëra nga material rezistent në abrazivitet dhe goditje zakonisht jan të mveshura me një shtresë mangani. Edhe grilla ndarëse punon me një sistem dhe bëhet ndarja e materialit shterpë I cili përmes një shiriti transportues bartet dhe stivohet në një vendë të caktuar. Fig 3.



Të dhënat e mundshme teknike për grilën ndarëse
Tip ZS 1020
Sip . sitëse 1.00-6.48 $m^2$
Nr. I rrot. (frekuenca) 960 rrot/min
Kapaciteti 3-120 $m^3$
Fuqia e el. 0,37-7.5*2 (kW)

| | | |
|---|---|---|
| | | 4.Thërmuesi me Nofulla  Thërmuesi me nofulla është I tipit GURSAN, një thërmues me kapacitet mjaft të madh. Kapaciteti I këtuijë thërmuesi varet nga dimensionet e pranimit të gurit e që në rastin tonë jan 0.90 x 1.10m kurse f.el që e vë në lëvizje nofullën është 90kW . kjo hapje apo fyti |

pranues I këtijë dimensioni mundëson një prodhim kapacitet të madh prodhimi rreth 150 $m^3$/ h. Principi I punës te ky thërmues bazohet në thërmimin e gurit me shtypje. Në pjesën e lëvizëshme në rotor është e vendosur nofulla e cila gjat lëvizjes poshtë lartë bënë që gurët e pranuar të shtypen nëpër murin frontal I cili është statik duke u thërmuar deri në gabaritet që I përshtaten hapjes në pjesën e poshtme. Dhëmbët e nofullës janë të përbërë nga mangani i cilai është mjaft rezistentë ndaj goditjeve dhe abrtazivitetit të gurëve.fig 4.

5. Shiriti kryesor transportues

Shiriti kryesor transportues është I vendosur nga thërmuesi primar e deri te thërmuesi sekondar , fig ,5



| | | |
|---|---|---|
| | | Seksioni tërthor i përbërë nga tri rrula I vendosur pjerrtazi në këndin prej 17-21° Siç shihet ky shirit është I përbër nga tri rrula të vendosura pjerrtazi me një kënd 17-21 ° . Shiriti I gomës në këtë pozicion duhet të jetë minimum tre shtresorë sepse u nënshtrohet të gjitha presioneve dhe ngarkesave të ndryshme përshkak se bënë transportimin e materialit që del nga mulliri primar. Forca e el. e cila e vë në lëvizje shiritin transportues varet nga gjatësia e shiritit dhe këndi I pjerrtësisë dhe kjo fel. nuk guxon të jet nën 7.5 kW kurse reduktori duhet të ket 60 rrot/ min. Nga ky shirit materiali I hërmuar kalon në parasite e cila bënë ndarjen e materialit 0-60 mm , ku permes një shiriti transportues ky material stivohet në një vendë të caktuar për tu përdorur nga kompania për nevoja të ndryshme kurse materiali mbi site kalon në mullirin primar me çekiça për tju nënshtruar procesit të ma tutjeshëm të thërmimit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | 6. Mulliri me Çekiça<br><br>Ky mulli është I përbërë nga çekiçë fluturues të cilët nën forcën e inercionit godasin gurët duke I thërmuar. Thërmimi vjen edhe si pasojë e goditjes së gurëve në murin frontal të pjesës statike të mullirit mëpastaj permes shiritit transportues shkon në sitën primare vibruese katër katëshe për tu ndarë apo seperuar në frakcione sipas llojit të sitave. |

| | | |
|---|---|---|
| | | 7. Thërmuesi rrotativ (sekondar)<br>Materiali I thyer në thërmuesin primar me traj, përems shiritit transportuas kryesor vjen në mullirin sekondar me çekiça dhe I nënshtrohet një bluarje sekondare duke u shëndrruar në gabaritet e dëshiruara të cilat klasifikohen me anën e sites primare vibruese. Nga sita vibruese përmes shiritave transportues materiali I seperuar grumbullohet nëpër pozicionet e caktuara I gatshëm për tju shpërndarë klientëve potenc<br><br>8. Sita primare vibruese tre katëshe<br>Materiali I cili thërmohet në mullirin me çekiça permes shiritit transportues shkon në sitën primare vibruese katër katëshë në të cilën bëhet ndarja e frakcioneve sipas gabariteve. Në këtë site bëhet ndarja e frakcioneve 0-4 mm; 4-8 mm; 8-16 mm; 16-32 mm , këto frakcioneve permes shiritave gjegjës transportues deponohen nëpër vende të caktuara kurse materiali mbi site gabaritet e të cilit janë mbi 32 mm shkojnë në ribluarje në mullirin rrotativ dhe në mënyrë ciklike materiali I cili është mbi 16 mm prap kthehet në ribluarje në mullirin me çekiça. Sipërfaqja sitëse e sites është 12 $m^2$ |




**Pershkrimi I procesit te eksploatimit ne mihjen siperfaqsore**

Për të eksploatuar gurin gëlqeror kryhen këto procese teknologjike: Behet largimin i shtresës së dheut (sterilit), shpim, minim, ngarkimi dhe transporti . Për realizimin e procesit teknologjik për eksploatimin e gurit gelqeror kompania posedon këto pajime:

| | | |
|---|---|---|
| | | Garnitura për shpim, një ekskavator, një bulduzher , një lopatë ngarkuese dy deri tre kamion special për bartjen e shkëmbit të minuar gjer te gurthyesja me seperacion.<br>Punimet e eksploatimit të gurit gelqeror në këtë vendburim zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim. Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e shkëmbinjve- gëlqeror në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:<br>- lartësia e shkallëve është 10m.<br>- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.<br>- pjerrtësia punuese e shkallës është 70 gradë.<br>- eksploatimi i gëqerorve kryhet përmes5 shkallëve.<br><br>- sterili dhe materiali humusor nëpër rrugë të |

| | | |
|---|---|---|
| | | projektuara bartët dhe deponohet ne deponin e caktuar enkas për te e pastaj deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.- karakteristikat hidrogjeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferik me punime minerare lehtë largohen nga karriera<br>- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia ne nivelin e kuotës 702m dhe nga thellësia ne nivelin e kuotës të shkallës 648m, me disnivel prej 50m.<br>Rezervat e përgjithshme eksploatuse (të shfrytëzueshme) ne pjesët e ngastrave të lartshënuara ne bazë te llogaritjes janë afro 280.000 $m^3$<br>Nëse i ndajmë rezervat e përgjithshme me prodhimtarin e planifikuar vjetore do të fitonim periudhën kohore për të cilën kryet eksploatimi i mihjes sipërfaqësore të gurit gëlqeror në kufij e fushës |

| | | |
|---|---|---|
| | | eksplatuse.<br>280.000 m$^3$ : 30.000m$^3$/vjet = 9 vite me mundësi zgjerimi.<br>Prandaj kohë zgjatja e gurores në kufij të projektuar eksploatues eshte:<br>1- vit ....................................................................... 30.000 m$^3$<br>5 - vite x 30.000m$^3$/vjet ........................................ ... 280.000 m$^3$<br>Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë . Etazhet zhvillohen në drejtim veri- jug, dhe atë në një kat bëhet shpimi dhe përgatitja e fushës për minim , kurse në katin ( etazhin ) më lart bëhet ngarkimi dhe transporti i masës së minuar më herët . Minimi bëhet me eksplozive Amonali i përforcuar i cili është treguar efektiv në shfrytëzimin e gurit gëlqerorë.<br>Për të pas një pasqyrë reale të lëndëve plasëse ne në këtë raport do ti japim karakteristikat teknike të Amonalit të përforcuar. |

Tipi i lendes plasëse

1. Amonium nitrat.................................-82÷1.5%
2. Trimitro trotuol.................................- 14 ÷ 1%
3. Tallash druri....................................- 4 ÷ 0.5%

Karakteristikat

| | |
|---|---|
| Dendësia kg/l | 1.1-1.15 |
| Shpejtësia e detonimit m/s | 4400-4500 |
| Përcjellja e detonimit cm | 4-9 |
| Bilanci i oksigjenit % peshore | 4 |
| Vëllimi i gazrave L/kg | +0.24 |
| Lirimiinxehtësisë $^0C$ | 2564 |
| Presionii deponimit $Dn/m^2$ | 56619 |
| Diametri i llokumit Ø | 60 |

| | | |
|---|---|---|
| | | Në rastin e minimit të gurit gelqeror ne Gadime të Ulët është e kalkuluar largësia e gjuajtjes së copave shkëmbore, gjë që nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën. Konsumi specifik për një vrimë është llogaritur të jetë 30 kg e cila është 36 herë më e vogël se sasia e lejuar për shkallen e tretë të merkalit ku shpejtësia e lejuar e oscilimeve të trupit është 0.4 deri në 0.8 cm/s. Por tani me sistemin e ri të minimit, do të kemi sigurinë ma të madhe. Nga kjo mundë të konstatojmë që veprimet sezmiologjike në objektet sipërfaqësore duke marrë parasysh distancën e larguar është i pranueshëm në procesin teknologjik.<br>Rrezja e zonës së rrezikut caktohet në bazë të përdorimit të eksplozivit që aktivizohet:<br>$R = 5\sqrt{Q} = 5\sqrt{2478} = 248{,}89 \approx 250\ m^{3}$<br>R- zona jo e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit<br>Q- sasia e eksplozivit për një minim<br>5- koeficient i cili merret për distancën e palosjes së masës së shkëmbit (m) |

| | | |
|---|---|---|
| | | Prandaj minimet ne ket lokalitet nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën sepse objektet banuese janë mbi 800 m, kurse zona e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit është ≈ 250m. Nga minimi gjithmonë duhet të ketë kujdes që madhësia e shkëmbit të minuar të jetë në granullometri të lejuar për fytin e thërrmueseve primare, gabaritet e mdhenjë nuk guxojnë të jenë prezent më tepër se 20% nga madhësia e fytit pranues. |
| 1.1.2. | Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik | Bazuar ne fortësinë te cilën e kanë gëlqerorët , së këndejmi edhe për ketë VB është i pa shmangshëm aplikimi i teknologjis se shpim- plasjes për rrëzimin e tyre.Andaj fazat neper te cilat dot te kaloj procesi i |

| | | |
|---|---|---|
| | | punës janë :punët në zbulim,shpimi i birave,minimi,ngarkimi,transporti dhe përpunimi<br>Për kryerjen e procesit teknologjik të shfrytëzimit te gurit gelqeror , Kompania " GERLICA COMPANY" Sh.p.k.Babush-Ferizaj Eksploatim,thermim dhe seperim i gurit gelqeror, ne Gadime e UlëtLipjan përdoren këto pajisje :<br>-Garniturë shpuese<br>-Lopat ngarkuese<br>- Autokamion<br>- Bolduzer<br>- Eskavator<br>Zgjedhja e garniturës shpuese<br>Garnitura shpuese duhet te ketë këto karakteristika teknike:<br><table><tr><td>1</td><td>Prodhim</td><td></td></tr></table> |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2 | Konsumi specifik i ajrit te ngjeshur | 11[m |
| | | 3 | Shpejtësia e shpimit | 12-18) |
| | | 4 | Thellsia maks. e shpimit | 25[m |
| | | 5 | Lloji i çekanit shpues | OP-15 |
| | | 6 | Diametri i bires | -115) [ |
| | | 7 | Gjatesia e shufrave te shpimit | :2 dhe |
| | | 8 | Fuqia e kompresorit | 125 [k |
| 1.1.3. | Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve | Fabrika e bluarjes së gurit "GËRLICA COMPANY" Sh.p.k. fillon punën në ora 7:00 të mëngjesit deri në ora 17dhe për 9 orë mund të prodhohen deri në mbi 500m$^3$ frakcione të gurit gëlqeror, mirpo orari ede mundë të ndryshoj sepse mvaret nga kërkesat e klientëve dhe përgatitja e tyre , poashtu orari mvaret edhe nga sasia e frakcioneve të gurit të porositur nga klintët. Nëse kjo sasi e kalon 500m3 , përshkak të specifikave të prodhimit orari I punës zgjatet por gjithnjë në marrveshje me punëtorët duke pasur parasyshë edhe pjesën stimulative të punëtorve kur punohet jasht orarit. Numri i të punësuarve është 15. | | |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| 1.1.4. | Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar | Kapaciteti teorik ndryshon nga ai praktik.<br>Arsyeja: Natyra e punës, pengesat e ndryshme gjatë punës. Kapaciteti praktik realizohet në masën 70% të atij teorik<br>, kurse prodhimi ditor në këtë impiant variron sepse prodhimi varet nga shumë faktorë siç janë:<br>1. Gjendja teknike e impiantit<br>2. Nevoja apo kërkesa e tregut si dhe<br>3. Kualiteti i lëndës së parë. |
| 1.1.5. | Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse, energjisë, uji, etj. | • Energjia elektrike<br>• Guri i minuar<br>• Nafta<br>• Uji<br>. Nafta karburant të cilën mjetet transportuese e shfrytëzojnë si lëndë djegëse. Për nevojat e veta kompania furnizohet nga pika e karburantit "Patroni" e cila është pran biznesit të kësaj kompanie. Pra kompania furnizohet direkt në pikën e karburantit pa pasur nevojë që të mban qfardo rezervoari tjetër të |

| | | |
|---|---|---|
| | | naftës duke pasur parasyshë që pika e karburantit nuk është larg nga baza e"GËRLICA COMPANY"<br><br>Të gjitha pajimet në Gurëthyes punojnë me energji elektrike për të cilën kompania ka kontratë me KEDS-in.<br>Uji përdoret përveq nevojave sanitare përdoret edhe për rrëzimin e pluhurit që shkaktohet gjatë punëve operative brenda objektit dhe transportit edhe pse kjo sasi është shumë e vogël pothuaj e papërfillshme. |
| 1.1.6. | Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre | Nuk ka ndonjë rezervoar ë fushën e shfrytëzimit |
| 1.1.7. | Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi | Si bazë ligjore për hartimin e këtijë projekti , kompania shfrytëzon këto ligje dhe udhëzime administrative.<br>Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij, ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra |

| | | |
|---|---|---|
| | | mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit daton ne vitin 2003, tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, në të cilin pos tjerash potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizik dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit apo mënjanimit të efekteve negative neë mjedis në kohën e duhur.<br>. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025<br>• Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147<br>• Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110<br>• Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160<br>• Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233<br>• Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102<br>• Ligji për Hlanifikim Hapësinor Nr. 04/L-174<br>• Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26<br>• Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 04/L-012<br>• Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2007 kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave<br>• Udhëzimi Administrativ Nr.06/2008 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe tranzit të mbeturinave.<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 20/2011 për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme<br>• Udhëzimi Administrativ Nr.25/2012 për Lejen Mjedisore<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë |

| | | |
|---|---|---|
| | | e karburanteve të lëngëta të naftës<br>• Udhëzimi Administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave Nr. 15/2012<br>• Udhëzimi Administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat per eliminimin e pasojave.<br>• Udhëzimi Administrativ.Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik . |

| 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT | | |
|---|---|---|
| 2.1. | **Lokacioni** | Gadime e Ulët-Lipjan |
| 2.1.1. | Numri kadastral i parcelës | për eksploatimin, bluarjen dhe seperimin e gurit gëlqeror dhe aktiviteteve tjera minerare në Gadime e Ulët pjesa lindore e Lipjanit, ne pjesët e ngastrave kadastrale Nr. 1049-13 S= 23500 m2 ;1049-4 S=13370 m2 |

| | | |
|---|---|---|
| | | ;1984-2 S= 16730m2 dhe1977-5 S= 7063 m2 Z.K., Gadime e Ulët; 562-4 S= 53120 m2 dhe 562-6 S= 49296 m2 ,z.k.Babush I Muhagjerve si dhe ngastra 1049-6 |
| 2.1.2. | Përshkrimi i zonës dhe lokacionit të impiantit sipas hartës së bashkangjitur | Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelorepër hartimin e Raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren .<br><br>Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuarnjë bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të jan prezantuare dhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me tëdhënat ekzistuesemorfologjike,gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike. Pjesët e ngastrave kadastrale Nr.1049-6; 1049-13 S= 23500 m2 ;1049-4 S=13370 m2 ;1984-2 S= 16730m2 dhe1977-5 S= 7063 m2 Z.K., Gadime e Ulët; 562-4 S= 53120 m2 dhe 562-6 S= 49296 m2 ,z.k.Babush I Muhagjerve ngastra gjendën në pjesën qendrore të Kosovës, 6 kilometra në Përëndim të Lipjanit, në anën e djathtë të autostradësFerizaj-Prishtinë,. Vendosja e mekanizmit për bluarje dhe seperim do të vendoset në lokalitetin e Gadimes së Ulët, ne pjesët e kadastrale të cekura më lartë. Pjesët e ngastrave të lartë cekura të paraqitura në Kopje plani zona kadastrale Bsbushi Muhaxherve dhe Gadime e ulët me *sipërfaqe të përgjithshme* ***S=163079 m²*** *që investitori kërkon pëlqimin mjedisor, Pasuri Shoqërore* komuna Lipjan, të cilën kompania "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K. Babush-Ferizaj, ka bërë marrveshje me i marr në shfrytëzim nga Komuna e Lipjanit. |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 2.1.3. | Përshkrimi i lokacionit të gjitha objekteve dhe aktiviteteve të tyre në kuadër të zonës sipas hartës së bashkangjitur | Ne lokacionin ku investitori planifikon të e bëj bluarjen dhe seperimin e gurit gëlqeror dheaktivitetet tjera minerare, ne kohën e kryerjes se raportit |

| | | |
|---|---|---|
| | | të VNM, nuk e ka pasur tërregulluar infrastrukturën rrugore dhe rrafshimin e terenit për fillimin e punimevepër vendosjen e mekanizmit për bluarje dhe seperim shoqëruar me aktivitetet tjera minerare.<br><br>Sipërfaqja prej S=9980 m2 pjesë e ngastrave kadastrale Nr. 1049-13 S= 23500 m2 ;1049-4 S=13370 m2 ;1984-2 S= 16730m2 dhe1977-5 S= 7063 m2 Z.K., Gadime e Ulët; 562-4 S= 53120 m2 dhe 562-6 S= 49296 m2 dhe 1049-6 ,z.k.Babush I Muhagjerve në të cilat planifikohet të bëhet për eksploatimin dhe vendosjen e mekanizmit për bluarje dhe seperim, gjendet e përcaktuar brenda **kufijve të të përcaktuar në kopjen e planit, që do të i bashkëngjitet raportit të Lejes Mjedisore** dhe do të shënohen ne vijim.<br><br>Ne kete lokacion ne afërsi të drejt për drejt nuk ekzistojnë objekte të banimit,objektet e banimit më të afërta gjenden ne largësi mbi 800m. Ne bazë tërezervave të gurit gëlqeror me të cilat disponon kompania,gurëthyesi duhet të punpjë për një kohë të gjatë dhe bazuar ne pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, ne këte lokalitet ekzistojnë edhe kompani tjera qëbëjnë bluarjen dhe seperimin. Sipërfaqja e tokës (ngastrave ku investitori do tëbëj bëj bluarjen dhe seperimin e gurit gëlqeror ) dhe për rreth tyre është e mbuluar me njështresë të pa përfillshme të humusit dhe me vegjetacion të ndryshëm : bar të egërtë mbirë vetë, kaçuba dhe therra si dhe ne vende të shumta shihet guri gëlqerorne sipërfaqe. |

| | | |
|---|---|---|
| | | <br><br>Sipas hartës shihet se nuk kemi ndonjë objekt banimi i cili do të ishte pengesë për zhvillimin e biznesit të kompanisë. |
| 2.1.4. | Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes | Në afërsi të këtijë impianti nuk ka zona të mbrojtura me ligj , dhe kjo zonë njifet si zonë e eksploatimit dhe seperimit të gurit gëlqeror në Gadime. |

| 3. **Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit** | | |
|---|---|---|
| 3.1. | Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit | Kompania ka një kuadër profesional të të punësuarish prandaj edhe bënë një menaxhim të mbrojtjes së mjedisit. Gjat eksploatimit dhe prodhimit të frakcioneve nuk ka emitim të pluhurit në hapësirë, mirëpo për të mos ndodhur kjo kompania përdorë ujin si mjet për ta rrëzuar pluhurin . Kjo bëhet përmes sistemit të tubacionit i cili është i vendosur nëpër pikat ku më tepër kemi sasi pluhuri si dhe përmes spërkatjes me anë të autocisternës. E gjitha kjo monitorohet dhe raportohet nga punëtorë profesional. |
| 3.1.1. | Raportimi | Do të kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fundë të qdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës. |

| **4. AJRI** | | |
|---|---|---|
| 4.1. | Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse | Pika të mundëshme të burimit të pluhurit janë:<br>1. Shkarkimi i rrërës nga kamionët në fortinë<br>2. Gjatë procesit të thërmimit dhe seperimit<br>3. Gjatë lëvizjes së makinave operuese në repart |
| 4.1.1. | Ndikimet në Ajër | Duke pasur parasysh teknologjinë e avansuar në këtë objekt si dhe sistemin e filtrimit, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë rajon është në nivel të lakmueshëm dhe nuk ka ndonjë shkak që do të ndikonte në ndotjen e ajrit .<br>Ndotje e ajrit ndodhë nga pluhuri i cili shkaktohet nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuse (gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit). Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, rrugët në të cilat operon kompania duhet të spërkatën me ujë.. Në këtë mënyrë niveli I pluhurit në ajër bie në nivel i cili nuk paraqet rrezik për mjedisin. |
| 4.1.2. | Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajërit | Për një vlerësim të tillë ne do ti drejtohemi institucioneve profesionale siçë është Instituti i Kosovës (INKOS), për të monitoruar dhe përgatitë një raport , të cilin më vonë do tja |

| | | |
|---|---|---|
| | | bashkangjesim këtijë aplikacioni. |
| 4.1.3. | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse | Shpërndarja materjeve ndotëse siçë janë gazrat , si burime konsiderohen të jenë makinat punuese në zonën operacionale , të cilat jan pothuaj në raport të njejt me lëvizjen e makinave në rrugë. |
| 4.1.4. | Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese | Paisjet për trajtimin e gazrave të liruara nga makineria në fushën operacionale duhet të kontrollohen gjat përgatitjes së makinerisë për tju nënshtruar kontrollimit teknik në fazën e regjistrimit të automjeteve. |
| 4.1.5. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër | Për të parandaluar dhe zvogëluar sasin e ndikimeve në ajër të krijuar gjatë realizimit të punëve pofesionale,nga mekanizmi për bartjen e lëndës,prodhimit, ngarkimit etj duhet të ndërmerren këto masa:<br>❖ Duhet të bëhet spërkatja me ujë e të gjitha siprfaqeve operacionale , rrugëve të pa asfaltuara nëpër të cilat bëhet edhe transporti i lëndës së prodhuar.<br>❖ Duhet që në të gjitha pikat kyqe dhe me rrezik të vendosen aparatet kundër zjarrit.<br>❖ Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i |

| | | |
|---|---|---|
| | | paisjeve teknologjike në mënyrë që gazrat që lirohen nga këto makina të jenë sa më pak të ndotura.<br>❖ Kamionët e transportit të lëndës duhet të mbulohen gjat trnsportit të lëndës<br>❖ Kompania duhet që çdo herë ta ketë cisternën e mbushur me ujë dhe të gatshme për punë. |
| 4.1.6. | Monitorimi i emisioneve | Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masve për zvogëlimin e këtyre ndikimeve.<br>Për këtë arsye parashihet një program monitorues për prodhimin e betonitt. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës duhet të bëhet me marrjen mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në |

| | | |
|---|---|---|
| | | ministri të mjedisit dhe planifikimit hapsinorë sipas kërkesës së tyre.<br><br>Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masve për zvogëlimin e këtyre ndikimeve.<br>. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës duhet të bëhet me marrjen mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në ministri të mjedisit dhe planifikimit hapsinorë sipas kërkesës së tyre. |
| 4.1.7. | Kontrolli dhe matjet | Për një vlerësim të tillë ne do ti drejtohemi institucioneve profesionale siçë është Instituti i Kosovës (INKOS), për të monitoruar dhe përgatitë një raport , të cilin më vonë do tja bashkangjesim këtijë aplikacioni. |
| 4.1.8. | Raportimet | Do të kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fundë të qdo viti kalendarik, ku do të paraqiten |

| | | |
|---|---|---|
| | | të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës. |
| 4.1.9. | Treguesi i emisioneve kryesore, përqendrimet dhe sasia vjetore | Duke u bazuar në të dhënat që dalin nga raporti i monitorimit nga Instituti INKOS për një kohë të caktuar, me një metodë krahasuese do të bëjmë një vlersim mesatar vjetorë rreth përqëndrimit të pluhurit në zonën operacionale |
| 5. UJI | | |
| 5.1. | Ujërat e ndotura | Ujëra të ndotura mundë të konsiderohen ujërat e shkaktuara nga reshjet atmosferike, vajrat e ndryshme të cilat aksidentalisht derdhen në tokë nga makinat të cilat me vete bartin edhe një sasi të pluhurit të depozituar gjat kryerjes së punëve operacionale. Për tu eleminuar kjo ndotje duhet që këto ujra të kanalizohen dhe të barten në basenet sedimentuese të tipit kaskadë |

| | | |
|---|---|---|
| | |  |
| 5.1.1. | Ndikimet në ujë | Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajra e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekur më lartë të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë n ndotjen e ujërave sipërfaqësore, të reshurat atmosferike s dhe nga ndotja e ujërave nëntokësore.<br>Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet m anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative jan edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj. |

<table>
<tr><td>5.1.2.</td><td>Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor, koncentrimet dhe sasia vjetore</td><td>Treguesit e ujrave të ndotura u cekën më lartë por nuk kemi ndonjë treguestë përhershëm sepse në ushtrimin e veprimtarive të lartëcekura nuk kemi ndotje të shkaktuara nga zhvillimi i punëve operacionale , por ajo ndotje vinte nga të reshurat të cilat janë periodike dhe na pamundësojnë që të kemi ndonjë të dhënë e cila mundë të konsiderohet vjetore.</td></tr>
<tr><td>5.1.3.</td><td>Trajtimi i ujërave të ndotura</td><td>Për tu eleminuar kjo ndotje duhet që këto ujra të kanalizohen dhe të barten në basenet sedimentuese të tipit kaskadë.<br><br></td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| 5.1.4. | Në rast kur ujërat e ndotura shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë | Nuk ka ndonjë veprim të tillë. |
| 5.1.5. | Në rast kur ujërat e ndotura nuk shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë | Nuk ka ndonjë veprim të tillë. |
| 5.1.6. | Të dhënat nga Lejet për përdorim të ujit | Nuk ka ndonjë veprim të tillë. |
| 5.1.7. | Leje Ujëore për shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura | Nuk ka ndonjë veprim të tillë. |
| 5.1.8. | Kontrolli dhe matjet | ------------------------------- |
| 6.1.9. | Raportimi | ------------------------------------ |
| 6. ZHURMA | | |
| 6.1. | Burimet | Zhurma e shkaktuar gjatë operacionit të prodhimit nga pajimet teknologjike të agazhuara në impiant është e karakterit lokal dhe nuk mundë të ket ndonjë ndikim në zonat e banuara.<br>Zhurma shkaktohet gjatë kryerjes së aktiviteteve prodhuese,nga makinat që e ngarkojnë lëndën, kamionët transportues etj.<br>Shfrytëzimi i pajimeve bashkohore për kryerjen e punëve operacionale mundëson që zhurma në në |

<table>
<tr><td></td><td></td><td>hapsirën ku është vendosur baza për prodhimin e betonit nuk do të jetë më e madhe se 90dB ( duke patur parasysh distancën e lokaliteteve të banuara rreth 3 km ). Sa më e madhe të jetë distanca edhe zhurma do të jet më e vogël.</td></tr>
<tr><td>6.1.1.</td><td>Kontrolli dhe matjet</td><td>Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën<br><table><tr><td rowspan="2">Zhurma</td><td colspan="3">Distanca(m)</td></tr><tr><td>10</td><td>50</td><td>100</td></tr><tr><td>90dB-niveli<br>Për paisje moderne</td><td>59</td><td>45</td><td>39</td></tr></table></td></tr>
<tr><td>6.1.2.</td><td>Raportimet</td><td>Do të kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fundë të qdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | | përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës. |

| 7. TOKA | | |
|---|---|---|
| 7.1. | Ndikimet në tokë | Ndikim negativ mund të kenë mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes së makinerisë dhe mjëteve të transportit si dhe mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike që shkaktohen nga vet njeriu.<br>Ndikim të madh negativ mund të kenë edhe derdhja e vajrave lybrifikues të cilat nëse bien aksidentalisht në tokë janë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta |

| | | |
|---|---|---|
| | | shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshme si dhe nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre. |
| 7.1.1. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë | Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në tokë gjat kryerjes së punëve operacionale, në kompani duhet të ndërmerren këto masa:<br>❖ Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuara që të mos lejohet kalbja e tyre në mënyrë që ato të mund të përdoren më vonë..<br>❖ Për ti parandaluar pasojat e erozionit duhet të bëjmë rikultivimin biologjik në ato pjesë ku është e mundur.<br>❖ Duhet ndërmarrë masa që vajrat e makinave dhe të pajimeve tjera të mos derdhen në tokë.<br>❖ Nëse për shkak të ndonjë avarie në fazën |

| | | |
|---|---|---|
| | | e prodhimit duhet bërë largimi i vajit nga ndonjë makinë, atëherë duhet patur kujdes që vaji të derdhet në ndonjë enë jo ujëlëshuese e cila duhet të vendoset nën makinën e cila riparohet.<br>❖ Të gjitha mbeturinat e ngurta që krijohen në lokalitet gjatë proçesit të prodhimit duhet të grumbullohen dhe të klasifikohen sipas llojit: si p.sh. ato metalike të grumbullohen në vende të posaçme e më pastaj ti shiten kompanive të licencuara për ripërpunimin e tyre kurse ato që mbeten për nevojat e Kompanisë të vendosen nëpër kontenjer të veçant në mënyrë që të mos jenë shkaktar të ndotjes së ambientit.<br>❖ Mbeturinat e lëngëta që krijohen me rastin e ndrrimit të vajrave nëpër makina duhet të vendosen nëpër kontejner të veçant e |

| | | |
|---|---|---|
| | | më pas tu jepen kmpanive të licencuara të cilat merren me riciklimin e tyre. |
| 7.1.2. | Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit | Rikultivimi i hapësirës ku është prodhuar duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe rikultivimit të mjedisit, të cilin duhet pa si një prioritet të rëndësishëm edhe në këtë lokalitet ku zhvillohet aktiviteti prodhues. Nga proqeset teknologjike për prodhimin e frakcioneve të gurit gëlqeror do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th substrate të pa përshtatshme për rikultivim. Substratet me përbërës të mbetjeve të sterilit të degraduar, që pa tjeter duhet ti nënshtrohen rehabilitimit gjerë në masën e përmirësimit të pjesërishëm të vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tijë me ate të rrethinës ashtu që të krijohet një substrat produktiv i |

| | | |
|---|---|---|
| | | përshtatshëm për rikultivimin bujqësorë dhe ate malorë. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshinë revitalizimin në tërsi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara nga punimet prodhuese.<br>Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:<br>Qëllimi i rikultivimit- i cili ndikon që pas përfundimit të punimeve operacionale,sipërfaqeve të degraduara prapë tu kthehet funksioni i tyre primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvoglohet ndikimi negativ i këtijë projekti në ekosistem.Planifikimi i shfrytëzimit të tokës-planifikohet që toka në lokalitetet e prodhimit të betonit të rikultivohet duke iu përshtatur gjendjes së përafërt me ate të rrethit. Rikultivimi është i lidhur me aktivitetet prodhuese, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e zonës operative të mbyllur.<br>Të gjitha aktivitetet e lartëshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime:<br>❖ Prodhimin e biomasës<br>❖ Rehabilitimin e peisazhit dhe kthimin e pamjes vizuele në harmoni me formën |

| | | |
|---|---|---|
| | | relefore të terenit.<br>❖ Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve operacionale.<br>❖ Zgjërimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit.<br>❖ Mveshja i sipërfaqeve gjveshura si pasojë e punimeve operacionale.<br>❖ Krijimin e një pejsazhi të bukur, të përafërt me ate të natyrës për rreth. |

| 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE | | |
|---|---|---|
| 8.1. | Plani për menaxhimin e mbeturinave | Kompania duhet të ketë një plan menaxhimi të mbeturinave sepse në të kundërtën ato do të bëheshin pengesë për zhvillimin e punëve operacionale për bluarjen e gurit gëlqerorë. Ky plan është i bazuar në selektimin , klasifikimin sipas llojit dhe deponimit të mbeturinave deri në riciklim. |
| 8.1.1. | Magazinimi i përkohshëm i mbeturinave | Mbrturinë në fushë të shfrytëzimit dhe gurëthyes konsiderohet edhe materiali shterpë, i cili është me |

| | | |
